

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

PROGRAMI  
MËSIMOR



GJUHË SHQIPE

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Сл. весник на РМ“ бр. 58/00 и 44/02) и член 24 и 26 од Законот за основно образование („Сл. весник на РМ“ бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 70/06 и 51/07), министерот за образование донесе наставна програма по предметот албански јазик за VI одделение на основното осумгодишно образование, односно за VII одделение за деветгодишното основно училиште.

## 1. HYRJE

QËLLIMET E MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE - Kl. VII-IX Mësimi i lëndës Gjuhë shqipe në ciklin e tretë të shkollës fillore nëntëvjeçare, nga kl. VII – IX ka për qëllim përvetësimin, thellimin, zgjerimin dhe sintetizimin e njohurive dhe aftësive (shkathtësive) konkrete të nxënësve për përdorimin e drejtë të gjuhës shqipe në të gjitha llojet e komunikimit si dhe nxitjen e interesimit për zhvillimin historik të gjuhës shqipe.

Përmes mësimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe nxënësit e përsosin aftësinë e të dëgjuarit, të lexuarit, të përjetuarit dhe shpjegimit e teksteve letrare. Gjithashtu aftësohen të krijojnë dhe të shprehin bukur me gojë e me shkrim në gjuhën letrare shqipe.

Përvetësimi i mirë i lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsia krijon bazë të mirë për zbatimin praktik të njohurive të fituara edhe në lëndët e tjera mësimore dhe luan rol të rëndësishëm në realizimin e procesit edukativo-arsimor përmes teksteve letrare e joletrare, në kuptimin e komponentëve estetikë, etikë, socialë, nacionalë..., që e përbëjnë kurikulën edukativo-arsimorë.

Sipas planit mësimor është paraparë që lënda Gjuhë shqipe dhe letërsia të mësohet 4 orë në javë, përkatësisht 144 orë mësimore në vit.

Lënda Gjuhë shqipe dhe letërsia ka status të lëndës së obligueshme mësimore.

### VËREJTJE:

Në bazë të dinamikës për aplikimin e edukimit dhe arsimit fillor nëntëvjeçar programi mësimor për nxënësit e klasës së VI të arsimit fillor tetëvjeçar në vitin shkollor 2008/09 është ekuivalent me programin mësimor për klasën e VII në arsimin fillor nëntëvjeçar.

## 2. QËLLIMET E MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE - Kl. VII-IX

Nxënësit:

- të fitojnë njohuri të mjaftueshme për rrugën e zhvillimit historik të gjuhës shqipe;
- të përvetësojnë shprehje dhe rregulla nga lëmi i fonetikës, morfologjisë, sintaksës dhe në mënyrë korrekte t'i zbatojnë ato gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim;
- t'i bëjnë dallimet mes kuptimeve leksikore e gramatikore të fjalëve;
- t'i njohin neologjizmat dhe ta kuptojnë rolin e tyre;
- t'i zbatojnë gjatë komunikimit normat drejtshkrimore;
- të dinë të interpretojnë tekste nga letërsia popullore dhe lehtërsia e shkruar (artistike);
- t'i njohin veçantitë dhe të bëjnë dallimin gjatë interpretimit të veprave lirike, epike e dramatike;
- të nxiten për leximin e veprave letrare të të gjitha llojeve e zhanreve;
- të aftësohen për lexim kritik e kreativ të veprave letrare, shkencore dhe të llojeve të tjera;
- të aftësohen për forma të ndryshme të të shprehurit me shkrim – ta përvetësojnë në veçanti shkrimin kreativ;
- të aftësohen për të interpretuar dhe vlerësuar vepra të ndryshme letrare, skenike, filmike, televizive dhe të mediejeve të tjera;
- të dinë t'i ndërlidhin përmbajtjet e lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsia me përmbajtjet e fushave të tjera mësimore - me artin figurativ, me artin muzikor, me filmin, me teatrin etj.;
- të aftësohen për zbatimin e informatave të pranuar përmes teknologjisë bashkëkohore të komunikimit.

### 3. QËLLIMET E MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE NË KLASËN VII

Nxënësit:

- të njohin rrugën e zhvillimit historik të Gjuhës shqipe dhe t'i dallojnë veçoritë kryesore të saj;
- t'i dallojnë klasat e fjalëve (pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjeratës);
- t'i njohin dhe kuptojnë kategoritë gramatikore të përbashkëta dhe të veçanta të pjesëve të ndryshueshme të ligjeratës;
- të njihen me grupin emëror (emrin dhe përcaktorët e emrit; mbiemrin e ndajfoljen dhe me shkallët e tyre; llojet e përemrave...) dhe të kuptojnë funksionet e fjalëve në fjali;
- të aftësohen ta zgjedhojnë foljen në mënyrën dëftore dhe të dallojë format e pashtjelluara të foljes;
- t'i dallojnë rrethanorët dhe ta kuptojnë rolin e tyre në fjali;
- t'i dallojnë fjalitë sipas përmbajtjes dhe përbërjes;
- të njihen me fjalitë e përbëra me bashkërenditje e me nënrenditje dhe me funksionin e lidhëzave;
- të njihen me mënyrat e ndryshme të formimit të fjalëve në Gjuhën shqipe;
- t'i dallojnë fjalët me kuptime të ndryshme leksikore gjatë komunikimit me gojë ose me shkrim;
- të njihen me stilet e ndryshme të ligjërimit (stili letrar, shkencor, administrativ...);
- të aftësohen për të dalluar shkrimet poetike nga shkrimet në prozë;
- ta dallojnë poezinë popullore nga poezia e shkruar;
- t'i klasifikojnë poezitë lirike sipas llojeve dhe motiveve;
- të aftësohen për analizën e kompozicionit të poezisë (strofa, vargu, rima);
- t'i njohin figurat letrare: metaforën, personifikimin, alegorinë dhe hiperbolën;

- të aftësohen për njohjen e dallimeve në mes të mitit, legjendës dhe gojëdhënës;
- të aftësohen për ta dalluar fabulën nga përmbajtja;
- të aftësohen të analizojnë një vepër letrare epike duke respektuar etapat e kompozicionit;
- t'i dallojnë format e të treguarit (në vetën e parë dhe në vetën e tretë);
- të aftësohen për të kuptuar veprat dramatike (dramën, tragjedinë, komedinë);
- të përvetësojnë njohuri dhe aftësi konkrete nga fusha e të shprehurit dhe krijimtaria;
- të njihen me mediet e shkruara dhe elektronike dhe të kuptojnë rolin e tyre në shoqëritë bashkëkohore.

## 4. QELLIMET KONKRETE

FUSHA PROGRAMORE: GJUHË			
KREU I Gjuha shqipe			
Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të fitojnë njohuri të mjaftueshme për vjetërsinë e gjuhës shqipe, për dokumentet e para të shkrimit shqip dhe për ndikimet e tyre në sferën e gjuhës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vjetërsia e gjuhës shqipe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dokumentet dhe shkrimet e para të shqipes</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lexime të dokumenteve të para të gjuhës shqipe dhe të fragmenteve të zgjedhura që vërtetojnë vjetërsinë e saj.</li> <li>Mësimi përmendësh i formulës së pagëzimit dhe ndonjë fragmenti të shkurtër nga "Meshari" i Gjon Buzukut.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>t'i dallojnë klasat e fjalëve (fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme);</li> <li>t'i kuptojnë funksionet e fjalëve të ndryshme në fjali: (kryefjalën, kundrinorin, përcaktorin, rrethatorin...).</li> <li>t'i kuptojnë se me anë të zëvendësimit mund të dallohet klasa dhe funksioni i fjalëve, ndërsa me anë të shtesës dhe heqjes mund të zbulohen njësitë gramatikore përbërëse të një grupi emëror, të një grupi foljor a të një fjale...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Klasat e fjalëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Klasat e fjalëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime për dallimin e klasave të fjalëve (pjesëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjeratës);</li> <li>Ushtrime për njohjen e funksioneve të fjalëve të ndryshme në fjali...</li> </ul>

## KREU II Grupi emëror

Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>t'i dallojnë kategoritë gramatikore të emrit (gjininë, numrin dhe rasën);</li> <li>t'i përdorin drejt emrat në të folur e në të shkruar dhe të formojnë emra nga lloje të ndryshme fjalësh...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Emri kategoritë gramatikore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Trajta</li> <li>Gjinia</li> <li>Numri</li> <li>Rasa</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime për njohjen dhe përvetësimin e kategorive gramatikore të emrit;</li> <li>Ushtrime për përdorimin praktik të emrave nëpër rasi, në të dy trajtat dhe në numrin njëjës e shumës.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>ta kuptojnë rolin e mbiemrit si përcaktor të emrit;</li> <li>ta kuptojnë funksionin dhe përshtatjen e mbiemrit me emrin;</li> <li>ta kuptojnë rolin e emrit në rasën gjinore e rrjedhore;</li> <li>ta dallojnë ndajshkrimin (e veçuar e të paveçuar) dhe përcaktorët e tjerë të emrit (numërorët dhe përemrat pronorë, dëftorë, pyetës, të pacaktuar).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktorët e emrit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcaktori</li> <li>Ndajshkrimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime për përvetësimin sa më të mirë të mbiemrit dhe kategorive gramatikore të tij;</li> <li>Ushtrime për njohjen e funksioneve që ka mbiemri në fjali...;</li> <li>Ushtrime me tekste përkatëse ku nxënësit do ta dallojnë mbiemrin si përcaktor të emrit dhe do të njihen me funksionin dhe përshtatjen e tij në rasë, në gjini etj.;</li> <li>Ushtrime me fletëza mësimore rreth përcaktorëve të tjerë të emrit (përemrin lidhor, pronor, dëftor, pyetës, të pacaktuar etj.).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mësojnë për ndajfoljen, hkallet e mbiemrit dhe të ndajfoljes.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbiemri dhe ndajfolja kategoria e shkallës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shkalla e mbiemrit dhe e ndajfoljes</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime për përvetësimin e shkallëve të mbiemrit dhe të ndajfoljes me qëllim të fitimit të njohurive në lidhje me kuptimin dhe ndërtimin e shkallëve krahasore dhe sipërore...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të aftësohen t'i përdorin drejt gjatë komunikimit përemrat vetorë dhe vetvetorë;</li> <li>t'i mësojnë trajtat e shkurtra dhe të plota të përemrave vetorë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përemri vetor</li> <li>Trajta e shkurtër</li> <li>Bashkimi i trajtave të shkurtra</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime për përdorimin e drejt të përemrave vetorë e vetvetorë gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim...</li> </ul>

Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>t'i kuptojnë format dhe funksionin e përemrave lidhorë, dëftorë, pronorë, pyetës dhe të pacaktuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Llojet e tjerë të përemrave (përemri lidhor, dëftor, pronor, pyetës dhe i pacaktuar)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përemri lidhor</li> <li>Përemri dëftor</li> <li>Përemri pronor</li> <li>Përemri pyetës</li> <li>Përemri i pacaktuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime me shembuj për dallimin dhe përdorimin e drejt të përemrave;</li> <li>Arsimtari do të përgatitë tekste të ndryshme, fletëza mësimore, etj., ku do të ushtrojë nxënësit rreth përcaktorëve të emrit...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të jenë në gjendje t'i dallojnë fjalët e prejardhura me parashtesa, me prapashtesa si dhe me parashtesa e prapashtesa;</li> <li>fjalët e përbëra dhe të përngjitura; familjet e fjalëve dhe disa çështje të drejtshkrimit të tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fjalët e prejardhura dhe të përbëra</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fjalët e prejardhura</li> <li>Parashtesat</li> <li>Prapashtesat</li> <li>Fjalët e përbëra</li> <li>Fjalët e përngjitura</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime për të qenë në gjendje ta bëjnë dallimin e njësisë bazë të fjalëve me ato të prejardhura me prapashtesim ose me prapashtesim, me bashkëngjitje ose të lidhura, me përngjitjen e dy e më shumë fjalëve.</li> </ul>
<b>KREU III Folja</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>të dinë të zgjedhojnë foljen në të tri zgjedhimet, duke u ndalur sidomos te disa folje të zgjedhimit të tretë që paraqesin problem;</li> <li>t'i njohin foljet e parregullta;</li> <li>t'i dallojnë format veprorë dhe joveprorë të foljeve, veçoritë kryesore kuptimore e ndërtimore të tyre, si dhe foljet pavetore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zgjedhimi dhe format e foljes</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zgjedhimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime praktike për klasifikimin e foljeve në zgjedhime;</li> <li>Ushtrime për njohjen e foljeve të parregullta brenda fjalisë...</li> <li><b>Mjetet:</b> teksti i gramatikës, leximi letrar, revistat, tekstet e përgatitura nga arsimtari dhe nxënësit, grafoskopi, videoshiritat, kompjuteri etj.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të aftësohen të zgjedhojnë foljet në të gjitha kohët e mënyrës dëftore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mënyra dëftore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mënyra dëftore</li> <li>Kohët e foljes</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime me tekste përkatëse për përdorimin e drejt të foljeve në të gjitha kohët e mënyrës dëftore;</li> <li>Ushtrime me tekste të përgatitura nga arsimtari, ku nxënësit pa vështirësi do t'i gjejnë foljet dhe do t'i klasifikojnë ato sipas zgjedhimit (I, II, III);</li> <li>Ushtrime për dallimin e foljeve të parregullta.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>t'i dallojnë format e pashtjelluara të foljes (pjesoren, paskajoren dhe përcjelloren).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pjesorja, përcjellorja dhe paskajorja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Format e pashtjelluara:</li> <li>Pjesora</li> <li>Paskajorja</li> <li>Përcjellorja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime për përdorimin praktik gjatë komunikimit të formave të pashtjelluara të foljes...</li> </ul>

## KREU IV FunkSIONET gramatikore

Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të aftësohen t'i përdorin fjalitë e thjeshta</li> <li>• ta njohin strukturën e fjalisë së thjeshtë në gjuhën shqipe e cila ndërtohet në mënyra të ndryshme (me emërzim, me përemërzim etj.);</li> <li>• ta kuptojnë se grupi emëror në disa raste mund të zëvendësohet nga një përemër; se një mbiemër mund të shndërrohet në një emër dhe anasjelltas; se një tip fjalie mund të shndërrohet në një tip tjetër (fjali pohore - fjali mohore, fjali dëftore - fjali pyetëse)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjalja e thjeshtë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjalja e thjeshtë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për përvetësimin e mënyrave të ndryshme të formimit të fjalive të thjeshta;</li> <li>• Ushtrime gojore dhe me shkrim për përdorimin e drejt të fjalive të thjeshta...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• t'i dallojnë klasat e fjalëve dhe ta kuptojnë se për nga natyra e vet fjala i përket një klase të caktuar (emrit, foljes, ndajfoljes etj.);</li> <li>• t'i kuptojnë funksionet e ndryshme të fjalës në fjali;</li> <li>• ta dinë kur është emri kryefjalë në fjali dhe kur është kundrinë ose pjesë tjetër plotësuese e fjalisë;</li> <li>• ta dinë se kur ndajfolja në fjali është në funksion të ndërtimit të rrethanorit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Funkzioni gramatikor</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për kategorizimin e fjalëve nëpër klasa të caktuara...;</li> <li>• Ushtrime për njohjen sa më të mirë të funksioneve që ka fjala në fjali (nxënësit do të gjejnë fjalë që paraqesin rrethana të kohës, të vendit, të shkakut, qëllimit, mënyrës, sasisë etj.).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen me nocionin e rrethanës dhe shprehjen e saj (me një grup emëror, me një grup foljor, me një ndajfolje me pjesë të nënrenditura etj.; me shprehjen e rrethanës së kohës (të periudhës kohore ose të momentit të veprimit - kur?; në ç'moment?; të vazhdimit të veprimit - për sa kohë?; të kufijve kohorë të një veprimi - që kur? deri kur?); me shprehjen e rrethanës së vendit, të pozicionit – ku? (të zhvendosjes – për ku? ) etj.;</li> <li>• t'i dallojnë rrethanorët e shkakut, të qëllimit, të mënyrës e të sasisë dhe të kuptojnë si shprehën ata, ç'kuptim kanë dhe si përdoren?</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrethanorët dhe llojet e tyre në fjali</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrethanori i kohës</li> <li>• Rrethanori i vendit</li> <li>• Rrethanori i shkakut</li> <li>• Rrethanori i qëllimit</li> <li>• Rrethanori i mënyrës</li> <li>• Rrethanori i sasisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për njohjen sa më të mirë të rrethanorëve të kohës, vendit, shkakut, qëllimit, mënyrës e të sasisë;</li> <li>• Ushtrime për përdorimin e ndajfoljeve ose të grupit emëror që tregojë rrethanë gjatë kryerjes së veprimit të shprehur nga folja;</li> <li>• Ushtrime për shprehjen e rrethanorëve të kohës, vendit, shkakut, qëllimit, mënyrës dhe të sasisë me ndajfolje, me përemër, me grup emëror, me ndihmën e një emri dhe të një përcaktori me parafjalën për etj.</li> </ul>



## KREU V Struktura e fjalisë

Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• t'i dallojnë dhe t'i përdorin mjetet gjuhësore me të cilat shprehet forma mohore ose pohore;</li> <li>• t'i përdorin mjetet shprehëse të pjesëzave në fjalitë pohore, të ndajfoljeve ose të lokucioneve ndajfoljore;</li> <li>• ta dallojnë ekspresivitetin e shprehur në fjalitë pohore pyetëse ose nxitëse pa pjesëza ose pa mjete tjera shprehëse etj.;</li> <li>• t'i përdorin mjetet shprehëse të mohimit me kallëzues të përbërë nga mund + folje në mënyrën lidhore ku marrin kuptim pohor etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e fjalive</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjalitë pohore</li> <li>• Fjalitë pohore nxitëse dhe pyetëse</li> <li>• Fjalitë mohore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për dallimin e llojeve të fjalive – llojet e mohimit (i plotë, i pjesshëm ); fjalia dëshirore (pohore e mohore); fjalia nxitëse (pohore e mohore); fjalia pyetëse (pyetje e plotë e pjesshme);</li> <li>• Të aftësohen të përdorin drejt shenjat e pikësimit në këta tipa fjalish;</li> <li>• Ushtrime praktike për përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ta bëjnë dallimin mes fjalisë së thjeshtë dhe fjalisë së përbërë;</li> <li>• t'i njohin dhe t'i dallojnë fjalitë me bashkërenditje dhe me nënrenditje;</li> <li>• t'i njohin lidhëzat e fjalive me bashkërenditje: e, edhe, dhe, si dhe, jo vetëm, jo vetëm që, as, por as, kurse, megjithatë, veçse, prandaj etj. dhe lidhëzat me nënrenditje që lidhin dy elemente që kanë marrëdhënie varësie ku, nga, ngado që, për shkak se, në mënyrë që, ndonëse, edhe pse, edhe sikur etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjalia e përbërë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjalia e përbërë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për dallimin dhe njohjen e strukturës së fjalive të thjeshta dhe të përbërave;</li> <li>• Ushtrime idhur me fjalinë e thjeshtë me një tërësi ndërtimi dhe fjalinë e përbërë me bashkërenditje me dy e më shumë tërësi strukturore që lidhen njëra me tjetrën;</li> <li>• Ushtrime për njohjen e pjesëve të fjalisë së përbërë;</li> <li>• Ushtrime për njohjen e funksionit të lidhëzave në fjalitë me bashkërenditje dhe me nënrenditje;</li> <li>• Ushtrime për përdorimit e lidhëzave më të shpeshta bashkërenditëse...</li> </ul>

KREU VI Fjalori dhe stili			
Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Stili i ligjërimit - ligjërimi i folur dhe ligjërimit i shkruar (ligjërimit libror, bisedor, i shkujdesur - i thjeshtë);</li> <li>• Stili funksional - stili i veprimtarisë shkencore e teknike, shtetërore e administrative, shoqërore e politike, letrare artistike, fetare...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Stili i ligjërimit</li> <li>• Stili funksional</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Stili i ligjërimit</li> <li>• Stili funksional</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për biseda të zakonshme në formë dialogu (bisede);</li> <li>• Ushtrime për stilin e shkujdesur - përdorimi i fjalëve joshqipe;</li> <li>• Ushtrime për stilin ose ligjërimit libror (letrar) dhe nevojën e përdorimit të fjalëve të reja (neologjizmave) dhe huazimeve;</li> <li>• Ushtrime rreth nuancave kryesore të stileve funksionale: stilit shkencor, shtetëror-administrativ, politiko-shoqëror, të letërsisë artistike dhe të stilit fetar.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të kuptojnë si është ndërtuar fjalori, duke e marrë si shembull fjalorin e ri të gjuhës shqipe...;</li> <li>• të aftësohen të gjejnë fjalët që dëshirojnë dhe ta përvetësojnë mënyrën e përdorimit sa më të lehtë të fjalorëve...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkimi i fjalëve në fjalor</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fjalori</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për gjetjen e fjalëve dhe shprehjeve në tipa të ndryshëm fjalorësh;</li> <li>• Ushtrime për fjalorin shpjegues (normativ, terminologjik, etimologjik, historik, enciklopedik), për fjalorin drejtshkrimor, për fjalorin dygjuhësh, për fjalorin e filozofisë...</li> </ul>
KREU VII Drejtshkrimi			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• t'i dallojnë trajtat e shkurtra të përemrave vetorë në njëjës dhe në shumës; ta përdorin drejt bashkimin e trajtave të shkurtra të dhanores me trajtën e kallëzores dhe bashkimin e trajtave me pjesëzën të;</li> <li>• t'i përdorin drejt nyjat e përparme në vargun e emrave dhe të mbiemrave të nyjshëm.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorimi i drejt i trajtave të shkurtra dhe i nyjës së përparme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajta e shkurtra</li> <li>• Bashkimi i trajtave të shkurtra</li> <li>• Nyjat e përparme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për përdorimin e trajtave dhe bashkimin e tyre, në njëjës dhe në shumës duke shkëputur ndonjë copëz teksti ku shprehen trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrave vetorë;</li> <li>• Ushtrime për përdorimin e nyjës në vargun e emrave në rasën gjinore dhe të mbiemrat e nyjshëm.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të aftësohen të shkruajnë datat e rëndësishme (datëlindjet, ngjarjet e rëndësishme historike...).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkrimi i datave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkrimi i datave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për shkrimin e drejtë të datave, të muajve...;</li> <li>• Ushtrime rreth përdorimit të parafjalës <b>më</b> para datave kur përdoret si plotës kohe brenda një fjalie: <b>Më</b> 20.XI.1972</li> </ul>

## FUSHA PROGRAMORE: LETËRSI DHE LEKTYRË (50 orë)

### Poezia

Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ta njohin lirikën popullore;</li> <li>• t'i dallojnë këngët e djepit, të dasmës dhe të dashurisë;</li> <li>• të dallojnë veçoritë e lirikës popullore nga ato të lirikës së shkruar...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lirika popullore (këngët e djepit, të dasmës dhe të dashurisë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lirika popullore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutime për këngët e djepit, të dasmës dhe të dashurisë;</li> <li>• Ushtrime për dallimin e lirikave popullore nga lirikat e shkruara.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të bëjnë analizën kompozicionale të një poezie lirike (strofa, vargu, rima...);</li> <li>• t'i njohin strofat me dy, tri a me më shumë vargje;</li> <li>• të dallojnë rimën e kryqëzuar dhe të puthur nga rimat tjera...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Strofa, vargu dhe rima</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Strofa</li> <li>• Vargu</li> <li>• Rima</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjimi i poezive të inçizuara (recitime nga artistë të mirënjohur...), ku dallohen qartësisht strofat, vargjet, rimat;</li> <li>• Ushtrime për njohjen e llojeve të strofës;</li> <li>• Ushtrime për dallimin e rimës së kryqëzuar dhe të puthur nga llojet e tjera të rimave...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ta dallojnë poezinë lirike si lloj letrar-poetik nga poezia epike;</li> <li>• të dallojnë himnin, poezinë sociale dhe elegjinë nga llojet tjera të poezisë lirike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e poezive lirike – himni, poezia sociale, elegjia</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Himni</li> <li>• Poezia sociale</li> <li>• Elegjia</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për njohjen, dallimin dhe recitimin sa më të bukur të poezive lirike (himneve, lirikave sociale, elegjive);</li> <li>• Biseda rreth motiveve të poezive të lexuara...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen me figurat e caktuara letrare;</li> <li>• ta kuptojnë rolin e tyre (fuqinë shprehëse) dhe të aftësohen për gjetjen e tyre në çdo krijim poetik...</li> </ul>	<p>Figurat letrare:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• metafora</li> <li>• personifikimi</li> <li>• alegoria</li> <li>• hiperbola</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metafora</li> <li>• Personifikimi</li> <li>• Alegoria</li> <li>• Hiperbola</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Leximi i poezive;</li> <li>• Diskutime për mjetet e përmendura shprehëse dhe qëllimi i përdorimit të tyre;</li> <li>• Ushtrime për përdorim praktik të figurave letrare në poezitë e shkruara nga nxënësit dhe diskutime rreth tyre.</li> </ul>

Proza			
Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ta dallojnë përrallën si krijim gojor dhe të njihen me elementet fantastike dhe reale të saj;</li> <li>• të njihen me mitin dhe legjendën dhe të aftësohet të bëjë dallimin mes tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përralla, miti, legjenda,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përralla</li> <li>• Miti</li> <li>• Legjenda</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime me tekste të zgjedhura për të mësuar për veçoritë e përrallës, mitit e të legjendës.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen me romanin dhe me ndërtimin e tij.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Romani</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Romani</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për njohjen sa më të mirë të romanit dhe të strukturës së tij...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen me kompozicionin si element i formës së veprës letrare pike...</li> </ul>	Kompozicioni i veprës epike: <ol style="list-style-type: none"> <li>a) paraqitja e veprimit</li> <li>b) thurja e veprimit</li> <li>c) kulminacioni</li> <li>d) peripecia</li> <li>e) shthurja e veprimit</li> </ol>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kompozicioni</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime dhe lexim në grupe për të përcaktuar elementet e kompozicionit;</li> <li>• Ushtrime: analiza e një vepre të lexuar sipas rregullave të mësuara, duke respektuar elementet e kompozicionit...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• t'i dallojnë gojëdhënat dhe fjalët e urta</li> </ul>	Llojet e tjera epike: <ul style="list-style-type: none"> <li>• gojëdhënat</li> <li>• fjalët e urta</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gojëdhënat</li> <li>• Fjalët e urta</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për dallimin e gojëdhënave dhe dhe fjalëve të urta;</li> <li>• Ushtrime për mënyrën e mbledhjes së gojëdhënave dhe fjalëve të urta...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• t'i dallojnë personazhet në veprën letrare;</li> <li>• të aftësohen të bëjnë përshkrimin fizik dhe shpirtëror të personazhëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personazhi - portretizimi i jashtëm dhe i brendshëm</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Personazhi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime rreth identifikimit të personazhit, përshkrimi i tij i jashtëm dhe i brendshëm...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ta dallojnë fabulën nga përmbajtja e veprës letrare;</li> <li>• ta përcaktojnë temën si çështje kryesore të tekstit letrar dhe idenë si mendim themelor...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fabula, tema dhe ideja veprës epike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fabula</li> <li>• Tema</li> <li>• Ideja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për dallimin e fabulës nga përmbajtja e veprës letrare;</li> <li>• Ushtrime për përcaktimin e temës dhe desë së veprës letrare...</li> </ul>

<b>Drama</b>			
<b>Objektivat</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Konceptet</b>	<b>Veprimtaritë dhe metodat</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojnë dramën nga gjinitë etjera letrare;</li> <li>• ta shndërrojnë tekstin dramatik në tregim...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drama (aktrimi i tekstit dramatik)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drama</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ta ndjekin një shfaqje teatrore dhe të diskutojnë rreth veçorive të saj...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihen me dialogun dhe monologun;</li> <li>• të diskutojnë dhe ta dallojnë dialogun dhe monologun në një vepër dramatike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dialogu dhe monologu si formë e të shprehurit të aktorit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dialogu</li> <li>• Monologu</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për aktrimin e një teksti dramatik (dialog);</li> <li>• Ushtrime për ta dalluar monologun nga dialogu...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• t'i dallojnë veçoritë e llojeve të dramës, veçmas të tragjedisë, të komedisë dhe të radio-dramës për fëmijë.</li> </ul>	Llojet e dramës: <ul style="list-style-type: none"> <li>• tragjedia</li> <li>• komedia</li> <li>• radio drama</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tragjedia</li> <li>• Komedia</li> <li>• Radio drama</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexime fragmentesh të zgjedhura të teksteve dramatike;</li> <li>• Shfrytëzimi i mjeteve audiovizuale (dëgjime dhe shikime dramash në disqe DVD);</li> <li>• Diskutime rreth veprave të shikuara/dëgjua...</li> </ul>
<b>Lektyra</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të fitojnë shprehje leximi të veprave të autorëve shqiptarë dhe të huaj;</li> <li>• të dinë të ritregojnë fabulën e lektyrave të lexuara;</li> <li>• ta përcaktojnë vendin dhe kohën e ngjarjes në veprën e lexuar;</li> <li>• ta përcaktojnë temën dhe idenë e krijimeve të lexuara poetike dhe epike;</li> <li>• ta përcaktojnë narratorin, llojin dhe gjininë e veprës së lexuar letrare;</li> <li>• të jenë në gjendje të diskutojnë e të shkruajnë për përmbajtjen e veprës së lexuar dhe për karakterin e personazhëve....</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lektyra (tituj të zgjedhur nga letërsia shqipe dhe ajo botërore)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lektyra</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për lexime dhe analiza me gojë dhe me shkrim të lektyrave sipas planeve të përgatitura paraprakisht nga arsimtari i ëndës (nxënësit ushtrojnë si dhe çfarë të shkruajnë në fletoret e tyre - të përcaktojnë kohën dhe vendin e ngjarjeve, të dallojnë personazhët kryesorë nga ata të dorës së dytë, të thellohen në kundërvëniet mes personazhëve...).</li> </ul>

## FUSHA PRGRAMORE: TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA (34 orë)

### Format e të shprehurit: të shprehurit me gojë dhe të shprehurit me shkrim

Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<b>I. Diskutimi</b>			
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ta kuptojnë rëndësinë e komunikimit të kulturuar;</li> <li>• të aftësohen të diskutojnë me argumente për tema të ndryshme, duke përdorur fjalë e shprehje të zgjedhura</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutimi si lloj i komunikimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime me diskutime (biseda) të improvizuara për situata të ndryshme të jetës së përditshme (në shkollë, në teatër, në autobus...). Diskutim lidhur me veprat e lexuara, me filmat e shikuar, me ndeshjet sportive; biseda te improvizuara telefonike etj.</li> </ul>
<b>II. Të shprehurit tregues</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të aftësohen të tregojnë me stil të pasur e me kronologji të saktë ngjarje të përjetuara, të dëgjuara ose të imagjinuara;</li> <li>• të aftësohen të vazhdojnë shkrimin e një teksti me hyrje të dhënë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregimi me kronologji të saktë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për pasurimin e fjalorit gjatë të shprehurit tregues (me gojë dhe me shkrim) për ngjarje të përjetuara, të dëgjuara ose të imagjinuara;</li> <li>• Ushtrime për të shprehurit tregues me kronologji të saktë;</li> <li>• Ushtrime për vazhdimin e një teksti me hyrje të dhënë apo të një rrëfimi të thjeshtë duke u bazuar në fjalët kyçe.</li> </ul>
<b>III. Të shprehurit ritregues</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të aftësohen për të ritreguar një krijim të lexuar letrar, një film të shikuar...;</li> <li>• të aftësohen të ritregojnë (me gojë ose me shkrim) në vetën e parë dhe në vetën e tretë;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ritregimi kreativ</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ritregimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për ritregimin (me gojë ose me shkrim) e një krijimi të lexuar letrar, një filmi të shikuar...;</li> <li>• Ushtrohet ritregimi i përmbledhur i një filmi të shikuar në vetën e parë dhe në vetën e tretë.</li> </ul>
<b>IV. Të shprehurit përshkrues</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të thellojnë aftësitë për të përshkruar sa më detajisht personazhe, objekte, sende, vende, dukuri</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkrimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkrimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrime për përshkrime të bukura personazhesh, objektsh, sendesh, vendesh dhe dukurish të ndryshme;</li> <li>• Ushtrime për të përshkruar sipas udhëzimeve të dhëna, duke u bazuar te pikëvështrimi i caktuar, zgjedhja e hollësive të nevojshme, qartësia a organizimit logjik etj.</li> </ul>

Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<b>V. Të shprehurit me shkrim për qëllime praktike dhe nevoja personale</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>të aftësohen të shkruajnë njoftime publike për ngjarje që pritet të ndodhin;</li> <li>të aftësohen të prezantojnë lajme të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njoftimi: lajmërimi dhe lajmi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njoftimi</li> <li>Lajmi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime për shkrimin e njoftimeve (lajmërimeve) publike për ngjarje të ndryshme;</li> <li>Ushtrime me shkrim për hartimin e një lajmi dhe për prezantimin e tij...</li> </ul>
<b>VI. Hartimet me shkrim</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>të aftësohen të shfaqin origjinalitet dhe imagjinatë në të hprehur...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjatë vitit bëhen 3 hartime me shkrim (një në gjysmëvjetorin e parë dhe dy në të dytin)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hartimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ushtrime parapërgatitore lidhur me përmbajtjen dhe strukturën e hartimit, stilin e të shprehurit, drejtshkrimin dhe pamjen e jashtme të hartimit...</li> </ul>
<b>FUSHA PROGRAMORE: KULTURA E MEDIËS (10 orë)</b>			
Objektivat	Përmbajtja	Konceptet	Veprimtaritë dhe metodat
<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të dallojnë mediet e shkruara nga ato elektronike/digjitale;</li> <li>të kuptojnë rolin e medieve në shoqëritë bashkëkohore;</li> <li>të njohin mënyrën e funksionimit të medieve - ecurinë e punëve nga marrja e informacionit e gjer tek përpunimi dhe publikimi i lajmit...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mediet e shkruara dhe ato elektronike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mediet e shkruara</li> <li>Mediet elektronike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Organizohen vizita grupore nëpër qendrat e medieve lokale e nacionale, me ç'rast nxënësit njihen me ambientet, me mjetet e punës dhe me mënyrën e funksionimit të një mediumi të shkruar apo elektronik;</li> <li>Lexojnë artikuj të zgjedhur të medieve të shkruara, shikojnë bashkë emisione të përshtatshme për moshën e tyre kurse më pas bisedojnë për ngjashmëritë dhe dallimet e llojeve të ndryshme të medias, rolin e tyre në shoqëritë bashkëkohore...</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të njihen me internetin dhe rolin që luan ai sot në jetën shoqërore dhe në jetën e shkollare dhe qytetarëve akademikë...</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Interneti</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Interneti</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Në kabinetin e informatikës demonstron kështu në rrjetin e internetit dhe ushtrohet kërkimi i faqeve me të dhëna dobiprurëse për nxënësit (bie fjala, hapen faqet interesante mbi historinë e lindjes dhe zhvillimit të Gjuhës shqipe).</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• të aftësohen të kërkojnë librin e nevojshëm në katalogët dhe kartotekat e bibliotekës së qytetit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Biblioteka</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Biblioteka</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizohen vizita në bibliotekën më të afërt, me ç'rast nxënësit njihen nga bibliotekari për mënyrën e funksionimit të institucionit, për llojin e shërbimeve që ofron biblioteka dhe për mënyrën më të lehtë të kërkimit dhe të gjetjes së librit/tekstit të kërkuar..</li> </ul>
---	--	--	--

## 5. UDHZËME DIDAKTIKE

Programi mësimor i lëndës Gjuhë shqipe është përgatitur sipas kërkesave dhe metodave bashkëkohore, duke respektuar parimin e bashkëlidhjes (korelacionit) dhe integritit të të gjitha fushave programore, në veçanti të fushave programore Gjuhë dhe Letërsi. Përmbajtjet e lëndës Gjuhë shqipe (VII-IX) realizohen me anën e të dëgjuarit, të kuptuarit dhe të shprehurit (me gojë dhe me shkrim) të temave nga jeta e përditshme; me anën e të lexuarit dhe analizës së teksteve nga letërsia popullore dhe e shkruar, si dhe të teksteve me përmbajtje shkencore-popullarizuese dhe informative nga libri i leximit, revistat dhe nga burimet tjera. Në përmbajtjet e zgjedhura duhet të mbizotërojnë temat e mirësjelljes, të shoqërimin, të dashurisë, të punës, të gëzimeve të jetës, të paqes e lirisë, të bukurive të natyrës, të kujdesit ndaj ambientit jetësor etj.

Të gjitha përmbajtjet e lëndës Gjuhë shqipe duhet të jenë në bashkëlidhje me përmbajtjet e lëndëve të tjera: me gjuhën e huaj (me qëllim të përvetësimit më të lehtë të terminologjisë, ligjeve dhe rregullave gramatikore të të dy gjuhëve); me lëndën e historisë (me qëllim të njohjes me zhvillimin historik të gjuhës, kur analizojnë, fjala vjen, këngë nga cikli i Gjergj Kastriotit, si figurë historike dhe si personazh letrar); me lëndën e gjeografisë (me qëllim të njohjes me dialektet e gjuhës shqipe); me artin figurativ (me qëllim të paraqitjes figurative të ngjarjeve dhe personazheve të teksteve të interpretuara letrare); me artin muzikor (me qëllim të përvetësimit më të mirë të njohurive mbi ritmin, rimën, figurat gjuhësore - asonancën dhe aliteracionin etj.).

Fusha programore Letërsia dhe lektura zë vendin kryesor në mësimdhënien e lëndës Gjuhë shqipe dhe realizohet me leximin dhe përshkrimin e teksteve poetike, epike dhe dramatike, por dhe të teksteve me karakter fantastiko-shkencor dhe informativ, duke pasur gjithnjë parasysh rritjen e shkallëshkallshme të nivelit të njohurive të nxënësve...

Fusha programore Gjuhë nuk përfshin vetëm çështjen e përvetësimit formal të gramatikës e të ligjshmërive të saj, të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit, sepse zotërimi i gramatikës funksionale vihet edhe në funksion të fushave programore Të shprehurit dhe krijimtaria, dhe Kultura e medias, duke përbërë kështu një tërësi të pandashme gjatë realizimit të procesit edukativo-arsimor.

Përmbajtjet e të gjitha fushave programore burojnë nga tekstet (artistikë, gazetareske, shkencore, fantastiko-shkencore) që shërbejnë si modele për krijimin e teksteve të reja nga nxënësit dhe japin mundësi për realizimin e të shprehurit dhe krijimtarisë (me gojë e me shkrim) në mënyrë sa më të pavarur, sa më origjinale e sa më funksionale.

Gjatë përgatitjes së planeve të punës arsimtari duhet t'i ketë parasysh kushtet që ofron shkolla (mjetet dhe pajisjet mësimore që ka në disponim) për realizimin e procesit mësimor, të përlllogarisë me kujdes kohën e nevojshme (numrin e orëve) për arritjen e objektivave të caktuar dhe të përdorë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies që do t'ia mundësojnë mbylljen e suksesshme të vitit shkollor.



### **Fushat programore:**

- Gjuhë – 50 orë
- Letërsi dhe lektyrë – 50 orë
- Të shprehurit dhe krijimtaria – 34 orë
- Kultura e medias – 10 orë

(Fushat programore realizohen gjatë gjithë vitit shkollor duke u ndërlidhur e duke u plotësuar me njëra-tjetrën, kurse fondi i përcaktuar i orëve sipas fushave shërben vetëm si orientim për mësimdhënësin)

Fushat programore realizohen gjatë tërë vitit shkollor të ndërlidhura, duke plotësuar njëra-tjetrën.

Nga fondi i përgjithshëm i orëve të parashikuara sipas fushave programore mund të bëhen shmangie të vogla në pajtim me veçantitë e mjedisit ku ndodhet shkolla dhe nevojat individuale të nxënësve. Po kështu, lejohen edhe disa shmangie që kanë të bëjnë me dendurinë e objektivave, përmbajtjeve dhe veprimtarive konkrete. Pra: numri i orëve mund të përshtatet (gjer në një shkallë të arsyeshme...) me nevojat e shkollës së caktuar (mjedisit jetësor prej nga vijnë nxënësit, statusit të tyre kulturor-shoqëror dhe arsimor, përgatitjeve paraprake të nxënësve).

### **Qasja e individualizuar ndaj punës edukativo-arsimorë**

Në bazë të njohurive shkencore për dallimet në zhvillimin e fëmijëve, është e nevojshme të bëhet përshtatja e mësimdhënies me zhvillimin dhe me nevojat e arritjet individuale të nxënësve. Me fjalë të tjera, nevojitet zbatimi i teknikave dhe strategjive që i kërkon qasja e individualizuar me detyra të diferencuara gjatë realizimit të punës edukativo-arsimorë me nxënësit. Në këtë mënyrë mund të arrihen më së miri standardet e përcaktuara në fund të ciklit të tretë të shkollës fillore nëntëvjeçare.

### **Përfshirja e prindërve në veprimtarinë e mësimdhënies**

Familja është shkolla e parë për nxënësit dhe një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e tyre. Prandaj, gjatë realizimit të objektivave, përmbajtjeve dhe veprimtarive në lëndën Gjuhë shqipe duhet të sigurohet komunikimi bashkëpunues me prindërit e nxënësve dhe përfshirja e tyre në punën e shkollës, në funksion të: zhvillimit dhe përkrahjes së marrëdhë-

nieve prind - nxënës; kultivimit dhe zhvillimit të kulturës së të folurit në familje; realizimit të disa objektivave dhe përmbajtjeve të programit dhe të organizimeve letrare në kuadër të shkollës; informimit të prindërve; këmbimit të përvojave sa u përket specifikave të nxënësit dhe veprimeve ndaj tij etj.

### **Mjetet mësimore**

- Për realizimin e mësimdhënies së lëndës Gjuhë shqipe, përveç tekstit themelor, të lejuar nga ministri i arsimit dhe shkencës, këshillohet shfrytëzimi i doracakëve të ndryshëm, fletoreve të punës, librit të gjuhës, të udhëzuesve metodikë për realizimin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë edukativo-arsimorë...
- Burimet e të mësuarit në mjedisin e afërt: resurset e mjedisit që do të vëzhgohen e do të përshkruhen, objekte me karakter kulturor, edukativ, publik dhe shërbyes (dyqan, kinema, teatër, muze, park nacional, bibliotekë, stacion autobusësh etj.), situata me komunikime të ndryshme mes njerëzve në shkollë, në familje dhe në rrethin jetësor.
- Enciklopedi dhe fjalorë shpjegues të ndryshëm.
- Softuerë arsimorë kompjuterikë për pasurimin e kulturës së të folurit e të kulturës gjuhësore – programi toolkid dhe CD- ROM-a të tjerë multimedialë të verifikuar me lojëra edukative përkatëse – të verifikuara nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të RM-së.
- Revista të përshtatshme për moshën e nxënësve, të verifikuara e të miratuara nga MASH.
- Krijime letrare nga autorë të njohur shqiptarë e të huaj (që për nga përmbajtja dhe vlera estetike i përgjigjen moshës së nxënësve)
- Mjete audio-vizuale, auditive, vizuale dhe mjete të tjera me veti kinetike – programe televizive, emisione me karakter edukativ, filma të animuar dhe artistikë; videokaseta, disqe të DVD e CD-së me filma të animuar e me filma artistikë dhe me tekste të letërsisë popullore dhe artistike, me ngjarje të regjistruara, ditëlindje, me shfaqje teatrore etj.; audiokaseta me zëra të inçizuar, emisione lajmesh, tekste të lexuara në mënyrë artistike; aplikacione, ilustrime, makete; skena teatrore; sende të lëvizshme me efekte akustike dhe sende të tjera sipas nevojave që kërkon mësimdhënia e kësaj lënde.

## 6 KUSHTET HAPËSINORE

Mjedisi i mësimdhënies (klasa etj.) duhet t'i ketë kushtet themelore për zhvillimin normal dhe aktiv të veprimtarisë mësimore. Orenditë e klasës të mund të zhvendosen me lehtësi për t'u përshtatur me aktivitetet dhe format e punës si dhe të mundësojnë komunikim aktiv dhe pa pengesa në relacionin nxënës-nxënës, nxënës-mësimdhënës. Klasa duhet të ketë këndin e bibliotekës, këndin për lojë dhe këndin për ekspozita dhe aktivitete të tjera. Kushtet hapësinore duhet të jenë në përputhje me Normativin për kushtet hapësinore të miratuar nga ana e ministrit të arsimit dhe shkencës me vendimin nr. 07-1830/1 të datës 28.02.2008.

## 7. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Realizimin e programit mësimor për klasat VII – IX parashikohet ta bëjë mësimdhënësi që ka kryer shkollimin e lartë adekuat që është përcaktuar me Ligjin për arsimin fillor.

Наставната програма по албански јазик за шесто одделение на основното осумгодишно образование, односно за седмо одделение на основното деветгодишно образование ја донесе министерпт за образование и наука со решение бр. 07-2335/1 од 15.03.2008 година.